



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, duke vendosur sipas kërkesës së Feim Ismajlit nga Sllovia, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE**

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 1500 € (një mijë e pesëqind euro), Feim Ismajlit nga Sllovia për trajtim mjekësor të djalit të tij Valon Ismajli i cili trajtim është shumë i shtenjët dhe i papërbalueshëm për familjen.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 në mungesë të mjeteve financiare në Drejtoratin për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe në Zyrën e Kryetarit të Komunës do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport, në xhironlogarinë bankare 1300003012693697 në BPB për shkak të nevojës urgjente për trajtim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Feim Ismajli nga Sllovia

1Nr. 400-18417
Lipjan, më 20.05.2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti